

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

**GSK-KPA-A-041/14**

**Prishtinë,  
2 Dhjetor 2015**

Në çështjen juridike të:

**L.V.**  
Ulpiana S-11 2/166  
Prishtinë

**Ankuesi**

kundër.

- 1. S.K. ,**  
Rr. "NATO", Nr. 42,  
Pejë
- 2. B.M. ,**  
Rr. "29 Nëntori" Nr. 8/4  
Pejë
- 3. T.I. ,**  
Rr. "Selman Riza" Nr. 22  
Gjakovë
- 4. S.R. ,**  
Rr. "Ali Pashë Tepelena", p/n  
Gjakovë
- 5. R.C. ,**  
Lakrishte, Hyrja 1, Nr.4  
Prishtinë

*R.C. përfaqëson gjithashtu SaideKelmendi, Bashkim Mulliqi, T.I. and S.R.*

**Palët përgjegjëse në ankesë**

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anders Cedhagen, anëtarë, duke vendosur në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00845), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 2 dhjetor 2015, mori këtë

### **AKTGJYKIM**

1. **Ndryshohet Vendimi i Çertifikuar i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës si vijon: përveq R.C. palë përgjegjëse në kërkesë në shkallën e parë janë edhe S.K. , B.M. , S.R. dhe T.I. .**
2. **Refuzohet si e paafatshme ankesa e L.V. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/215/2013 të datës 21 gusht 2013, për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin KPA00845.**

#### **Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Më 29 Maj 2007, L.V. (në tekstin e mëtutjeshëm: Pala ankuese) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtutjeshëm: AKP) duke kërkuar rriposimin e banesës që gjendet në Prishtinë, Rruga “Beogrdaska 52”, Nr. 1, sipërfaqja prej 45,25 m<sup>2</sup> (në tekstin e mëtutjeshëm: prona e kërkuar), duke pretenduar se është pronare e pronës së kërkuar dhe se humbur mundësinë për të ushtruar të drejtën e saj pronësore në të për shkak të rrethanave që kanë rezultuar nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në vitet 1998/99.
2. Më 3 janar 2008, AKP-ja ka bërë identifikimin e pronës së kërkuar e cila doli të jetë e uzurpuar nga R.C. . Ai kishte nënshkruar deklaratën e pjesëmarrjes dhe thekson gjithashtu se përfaqëson S.K., B.M. n, S.R. n dhe T.I. (në tekstin e mëtutjeshëm së bashku: Palët përgjegjëse në ankesë).
3. Pala përgjegjëse në ankesë kishte marrë pjesë në procedurën para AKP-së, duke theksuar se Pala ankuese nuk është bartëse e të drejtës për sa i takon pronës së kërkuar.
4. Prona e kërkuar ka qenë objekt shqyrtimi dhe vendosjeje nga Komisionin për Çështje Pronësore Banesore (në tekstin e mëtutjeshëm: KÇPB). KÇPB-ja me vendimin HPCC/D/106/2003/B&C, ka miratuar kërkesën e kategorisë B (DS008075) të S.K. t (motra e E.G. ) që tani është palë përgjegjëse në kërkesë. Kërkesat e kategorisë C (DS003476 dhe DS606736) e V.R. (ku pala ankuese ishte palë e interesuar) ishte hedhur

poshtë. Kërkesa për rishqyrtim e V.R. (Paraqitësja e kërkesës e parë) dhe L.V. (Paraqitësja e kërkesës e dytë) ndaj vendimit të shkallës së parë në lidhje me kërkesën e kategorisë C është refuzuar me vendimin HPCC/REC/61/2006 të datës 19 mars 2006.

5. Në paragrafet 29 dhe 30 të vendimit grupor, i cili sipas vendimit të vërtetuar aplikohet në rastin konkret të kërkesës, theksohet se V.R. (Paraqitësja e kërkesës e parë) dhe L.V. (Paraqitësja e kërkesës e dytë dhe tani Ankuesja) pretendojnë se E.G. , motra e Paraqitëses së kërkesës e kategorisë B (në lëndën para Gjykatës Supreme Palë përgjegjëse në ankesë (S.K.), nuk ka qenë asnjëherë pronare e pronës së kërkuar meqenëse procedura e privatizimit nuk ishte përmbyllur për shkak se Ministria e Financave nuk e kishte lejuar privatizimin e pronës para se motra e Palës përgjegjëse në ankesë të kishte vdekur në janar të vitit 1995. E ndjera E.G. kishte vetëm të drejtën e banimit e cila nuk do të mund të kalohej në Palën përgjegjëse në ankesë, meqenëse ajo nuk është anëtare e ngushtë e familjes. Më tutje, palët kërkuese në atë procedurë kanë pretenduar se nuk kishte diskriminim në procedurën para Ministrisë së Financave, meqenëse blerja nuk ishte interretnike. Paraqitësit e kërkesës në atë procedurë kanë theksuar se Pala përgjegjëse në ankesë ka falsifikuar nënshkrimin e motrës së vdekur meqenëse kërkesa ishte paraqitur në shkurt të 1995, pas vdekjes së motrës. Në fund, palët kërkuese theksuan se Ministria e Financave nuk kishte refuzuar të lejonte privatizimin e pronës së kërkuar por Paraqitësi i kërkesës i kategorisë B (Pala përgjegjëse në kërkesë) nuk kishte kompletuar dokumentet e tjera të nevojshme të kërkuara nga ana e Ministrisë së Financave. Paraqitësja e dytë e kërkesës thekson se ajo e kishte blerë pronën e kërkuar nga Paraqitësja e parë e kërkesës në vitin 2001 (Paraqitësja e kategorisë C).

DÇPB -ja gjen se motra e ndjerë e Palës përgjegjëse në ankesë kishte blerë pronën e kërkuar në vitin 1994 dhe se e kishte paguar në tërësi çmimin e shitëblerjes.

6. Më tutje DÇPB në arsyetimin e saj thekson se fakti i mosdhënjes së lejes nga ana e Ministrisë së Financave ende në fuqi nuk mund të vë në pikëpyetje këtë përfundim edhe nëse shitja nuk ishte nderretnike.

E vetmja arsye se për se shitja nuk ishte ligjore dhe e përfunduar ishte për shkak se ishte mbrenda sferës së Ligjit për Qarkullimin e Pronës nën rrethanat e veçanta (Gazeta Zyrtare e SRS 30/89) e plotësuar me ligjin e publikuar në Gazetën Zyrtare të RSS 42/89. Në këto rrethana lënda është dashur të vendosej meqë nuk ka qenë e nevojshme për Palën përgjegjëse në ankesë ose motrës së saj që të kërkonin leje nga Ministria e Financave. Meqenëse, V.R. në rrugën ligjore nuk ka mundur të fitonte të drejtën e pronësisë në pronën e kërkuar pasi bartësi i së drejtës së banimit paraprakisht ia kishte

shitur pronën e karkuar motrës së Palës përgjegjëse në ankesë, Pala ankuese nuk ishte në gjendje për t'ia bartur të drejtën e pronësisë asaj.

7. Më 21 gusht 2013, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin nr. KPCC/D/R/215/2013 hedhi kërkesën e Ankueses si çështje e gjykuar apo *res judicata*, me arsyetimin se e njëjta kërkesë e saj dhe për të njëjtën banesë, e regjistruar në HPCC Nr. DS003476 dhe DS606736, është shqyrtuar dhe vendosur me vendimin e formës së prerë të KÇPB, HPCC/REC/61/2006, të datës 19 mars 2006.
8. Me 13 nëntor 2013, vendimi iu dorëzua Palës ankuese dhe Palës përgjegjëse në ankesë. Pala ankuese si datë të ankesës shkroi 12 dhjetor 2013. Por, sipas vulës në dokumente, AKP-ja pranoi ankesën të hënën me 16 dhjetor 2013 dhe sipas një vule tjetër me 19 dhjetor 2013. Me 26 mars 2014, Pala përgjegjëse në ankesë ka pranuar ankesën, por ajo nuk ka paraqitur ndonjë përgjegje.

**Arsyetimi ligjor:**

9. KKPK-ja në Vendimin e Çertifikuar si Palë përgjegjëse në kërkesë ka theksuar vetëm R.C. n. Meqenëse ai kishte paraqitur autorizimin e S.K. t, B.M. t, S.R. t dhe T.I. , Gjykat Supreme sipas detyres zyrtare kokludon se edhe këta katër persona duhet që të konsiderohen si Palë Përgjegjëse në kërkesë dhe si Palë përgjegjëse në ankesë. Gjykata Supreme *ex officio* ndryshon vendimin e çertifikuar sipas këtij përfundimi.
10. Ankesa është e papranueshme. Ajo nuk është ushtruar mbrenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Ankesave Lidhur me Pronën e Paluajtshme, duke Përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, e plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).
11. Vendimi i KKPK-ës i është dorëzuar Ankuesit me datë 13 nëntor 2013. Përfundimi i kohës prej 30 ditësh është dita e premte 13 dhjetor 2013. Sidoqoftë, sipas vulës në dokumente, AKP-ja ka pranuar ankesën (dhe Ankuesi ka ushtruar ankesën në AKP) më së hershmi me datë 16 dhjetor 2013. Data e shkruar nga Ankuesi në shkresën e ankesës, 12 dhjetor 2013, si datë e ankesës, nuk dëshmon se ankesa është ushtruar në atë ditë).
12. Gjykata nuk mund të gjej ndonjë arsye se pse Ankuesi duhet të arsyetohet për këtë vonesë. Ajo ishte njoftuar mjaftueshëm për afatit kohor dhe se Ankuesi nuk ka dhënë ndonjë arsye në lidhje me vonesën. Prandaj, ankesa duhet të hedhet si e pasafatshme.

13. Rrjedhimisht mbi të mësipërmen, sipas Nenit 13.3(b) të Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) dhe Nenin 196 të Ligjit Mbi Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**Këshillë ligjore:**

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

**Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit**

**Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it**

**Anders Cedhagen , Gjyqtare e EULEX-it**

**Urs Nufer, Referent i EULEX-it**